


Albanische Übersetzung des Merkblattes „In der Klasse Ihres Kindes hat es Kopfläuse?“ / Ausgabe 2012

## Fletudhëzim: „A ka morra në klasën e fëmijës suaj?“

### Më të rëndësishmet në pika të shkurtëra

- Secilit nga ne mund t'i ndodhi të ketë morra në kokë – bashkërisht mund t'i largojmë përsëri.
- Reagimi i shpejtë pengon ngjitjen e tyre në mjedisin shkollor.
- **Diagnostifikimi i morrave në kokë dhe mjekimi i tyre është çështje e prindërve.**
  - Kontrolloni ju lutemi që sot fëmijën tuaj dhe pjesëtarët tjerë të familjes (shih fig.poshtë).
  - Në qoftë se gjeni morra, trajtoni sipas udhëzimit të dhënë në faqen tjetër.
- **Fëmijët mund të vijnë përsëri shkollën vetëm pas mjekimit me një ilaç kundër morrave.**

### Si duken dhe sa është kohëzgjatja e morrave



- **Vezët** („Thërijat“, nëse janë bosh) ngjiten fort në flokë. Ato duken njësoj si zbokth por prap nuk zhduken.
- Morrat kanë ngjyrën e njëjtë si të flokut dhe ikin nga drita. Me një kontrollë çasti në flokët e thata mund të shohim prezencën e morrave (shih poshtë).

### Mënyra adekuate e gjetjes së morrave dhe thërijave.

1. Flokët duhen lagur..
2. Jini dorëlibër në hedhjen dhe shpërndarjen e solucionit në flokët e lagura (i ashtuquajtur Conditio-ner).
3. Flokët e ngatërruara duhet krehur mirë (me brushë, me krehër).
4. Flokët duhet krehur që nga rrënja e deri tek maja.



Shembull: flokëte e lagura krihen me krehër të morrave që nga rrënja deri në majë.

5. Krehja me krehër morrash duhet të bëhet mbi një letër të bardhë (psh. letër kuzhine), në mënyrë që të duken morrat dhe vezët.
6. Larja e flokëve duhet bërë me kujdes.

### Skema e krehjes dhe mjekimit sipas gjendjes.

Rregull e përgjithshme: **krehja 7 herë në 4 javë!** Mjekimi me ilaç morrash bëhet vetëm nëse janë shfaqur morra të gjallë.

Ilaçet e morrave me efekt të veçantë janë Hedrin, K.Laus dhe Paranix. Ilaçet dhe krehërit e morrave mund të merren në farmaci dhe drogeri. Gjatë shtatzënisë, dhënies gji dhe tek fëmijët e vegjël duhet patur parasysh udhëzimin e paketimit.

Për informats të tjera në [www.gef.be.ch](http://www.gef.be.ch); [www.lausinfo.ch](http://www.lausinfo.ch).

### Skema e krehjes dhe e mjekimit

<b>Dita e 1-</b>	<b>Demonstrim: me krehër (shih faqen 1)</b> <b>A:</b> Nëse morrat janë të pranishëm mjekohen dhe hiqen me <b>ilaç morrash</b> (psh. Hedrin, K.Laus dhe Paranix). <b>B:</b> Nëse vetëm vezët/thërijat janë të pranishme, këto nxirren duke i krehur ( <b>pa ilaç morrash</b> ). <b>C:</b> Nëse nuk janë shfaqur morrat, vezët dhe thërijat, nuk ka nevojë për marrjen e masave të menjëhershme (por duhet të bëhet kontrolli i krehjes pas 7 ditësh!)
<b>Dita e 3</b>	<b>A+B:</b> Morrat e mbetur dhe vezët/thërijat hiqen duke u krehur (kontrollohet krehja).
<b>Dita e 7</b>	<b>A:</b> Mjekimi i dytë me <b>ilaç morrash</b> heqja e morrave, vezëve dhe thërijave me anë të krehjes. <b>B:</b> Heqja e vezëve/thërijave ekzistuese (ose të reja) me anë të krehjes. <b>C:</b> Kontrollimi i krehjes
<b>Dita e 10</b>	<b>A+B:</b> Kontrollimi i krehjes
<b>Dita e 14</b>	- Në qoftë se edhe më tutje gjenden morra (ose dalin të rinj), duhet filluar me trajtim të ri. Në ditën e parë sipas skemës A „Mjekimi me ilaç morrash dhe krehje“. - Nëse nuk ekzistojnë morra, vezë/thërija mjekimi ka përfunduar.
<b>Dita e 21</b> <b>Dita e 28</b>	Për shkak të mundësisë së bartjes së morrave, edhe gjatë dy javëve të tjera duhet të vazhdohet me kontrollimin e krehjes ( 1x në javë).

**Në qoftë se edhe pas trajtimit dyjavor me Hedrin gjendne morra ju lutemi të paraqiteni tek specialisti , i cili do t'ju jap këshillat e nevojshme!**

### Këshilla të rëndësishme

- Ju lutemi që në rast të shfaqjes së morrave dhe të parandalimit të përhapjes së tyre të informoni sa më shpejt rrethin tuaj, shkollën, kopshtin, miqtë etj.
- 1 herë në javë të bëhet kontrollimi rreth morrave tek të gjithë **pjesëtarët e familjes**.me anë të krehërit të morrave.
- Krehërit, brushat e flokëve të mbahen 10 minuta në ujë sapuni të nxehtë(60° C).
- Flokët e gjata të lidhen (lidhja direkte e flokut me flokun).
- Masat tjera nuk janë të domosdoshme. Përqëndrohuni në kokë.
- Parandalimi më i mirë tek fëmijët është 1 herë në javë larja (i ashtuquajtur Conditioner) e flokëve dhe krehja etyre sa janë të lagura me krehër morrash në formë kontrolli që të kapen me kohë

Për pyetje në dispozicionin tuaj është:  
Kopflausexpertinnen der  
Apotheke Sumiswald  
Telefon 034 431 43 43